

Përshëndetje e nderuara z. Gentiana Mjaku,

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës suaj për tu informuar lidhur me “Njoftim Publik”, të vendosur në rr. “Gjon Serreqi” në Prishtinë, ju njoftojmë si në vijim:

- Në Drejtorinë e Urbanizmit është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-37848/19 dt. 19.02.2019, në emër të aplikuesit Arsim Rexhepi nga Prishtina, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin kompleksit me ndërtesë të përkohshme afariste, në kuadër të bllokut urban “A6” të Planit Rregullues të Hollësishëm “Kodra e Trimave 1” 2017-2025, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 3218-0 dhe 3219-0 ZK Prishtinë.
- Kërkesa e referuar për caktim të kushteve ndërtimore për ndërtim të përkohshëm është e bazuar në “Rregullore për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik”, 01.Nr.110-288305 dt. 31.12.2014, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, përkatësisht në nenin 1, ku thuhet se, citoj *“Me këtë rregullore përcaktohen procedurat për dhënien e kushteve ndërtimore dhe lejeve ndërtimore personave fizikë dhe juridikë, për ndërtimin e objekteve me karakter të përkohshëm në pronësi të tyre, deri në realizimin e planeve rregulluese”*. Aplikuesi ka kërkuar caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e një ndërtese afariste-automekanik, me etazhitet P+0, jo ndërtesë shumë banesore.
- Aplikuesi i lartpërmendur, ka kërkuar caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtim të përkohshëm, vetëm për parcelat kadastrale nr. 3218-0 dhe 3219-0 ZK Prishtinë, për të cilat ka dëshmuar pronësinë, ndërsa parcela kadastrale nr. 3156-2, nuk është e përfshirë në trajtim sipas kësaj kërkesë;
- Ndërsa, për sa i përket deklarimit tuaj se askush nuk ju ka informuar lidhur me çështjen, gjatë prezencës suaj në Komunë, ju sugjeroj që për çdo informatë tjetër mund të paraqiteni në zyrën nr. 305 në katin e III të ndërtesës së Komunës në lagjen “Arbëria”, te zyrtarja përgjegjëse për lëndën Nazife Krasniqi. Palët pranohen në takim çdo të martë dhe enjte të javës, duke filluar nga ora 9.00 deri në 12.00.

Po ashtu, kjo drejtori, ju informon se kjo kërkesë është në procedurë të shqyrtimit dhe të vendosjes, dhe për të njëjtën do të nxirret vendimi përkatës, përkatësisht vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, pas plotësimit të të gjitha kritereve, konform rregullativës ligjore në fuqi.